



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. Prot.

Vlorë, më 20.04.2017

Vendim
Nr. 54, datë 20.04.2017

PËR
KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME NË
UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit **46** të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 20.04.2017

VENDOSI:

1. Krijimin dhe funksionimin e Komisioneve të Përherëshme në nivel institucional dhe në nivel njësie kryesore, si më poshtë:

A. Në nivel institucional krijohen:

1. **Komisioni i Sigurimit të Cilësisë së Brendshme në nivel institucional, (KSBCI).**

KSBCI përbëhet nga 7 anëtarë nga të cilët 6 janë personel akademik dhe 1 student, që vetëkandidohen dhe zgjidhen respektivisht nga asambleja e personelit akademik të institucionit, midis anëtarëve të saj dhe studentët me kohë të plotë të njësive kryesore për përfaqësuesin e tyre, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për KSBCI. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërret zgjedhjet për anëtar të KSBCI, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit. Funksionet kryesore të këtij komisioneve lidhen me garantimin e standardeve të cilësisë së institucionit si në aspektin akademik dhe në atë administrativ. KSBCI i institucionit i



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

kushton një vëmendje të veçantë procesit mësimor për çdo program studimi, rezultateve akademike të studentëve dhe marrëdhënieve të tyre me personelin akademik.

Në ushtrim të këtyre funksioneve KSBCI i institucionit harton rekomandime drejtuar autoriteteve apo organeve drejtuese, sipas natyrës së problematikës të konstatuar mbi parregullsitë e vërejtura së bashku me propozimet përkatëse. Në rast se pavarësisht këtyre rekomandimeve situata nuk ndryshon, KSBCI vendos në dijeni sipas rastit Këshillin e Etikës, Senatin Akademik ose Rektorin për marrjen e masave përkatëse.

Minimalisht në përfundim të çdo sezoni mësimor të vitit akademik, KSBCI nxjerr rekomandime mbi standardet e cilësisë në rang institucional.

2. Komisioni i marrëdhënieve me studentët në nivel institucional (KMSI).

KMSI përbëhet nga 7 anëtarë nga të cilët 6 janë personel akademik dhe 1 student, që vetëkandidohen dhe zgjidhen respektivisht nga asambleja e personelit akademik të institucionit, midis anëtarëve të saj dhe studentët me kohë të plotë të njësisë kryesore për përfaqësuesin e tyre, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për KMSI. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërret zgjedhjet për anëtar të KMSI, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit.

Funksionet kryesore të këtyre komisioneve lidhen me garantimin e standardeve të marrëdhënies së institucionit me studentët. KMSI i kushtojnë një vëmendje të veçantë marrëdhënieve të UV-së me studentët, shërbimeve akademike dhe administrative ndaj tyre, rezultateve akademike dhe marrëdhënieve të tyre me personelin, strukturat, autoritetet/organet drejtuese të institucionit.

Në ushtrim të këtyre funksioneve KMSI harton rekomandime drejtuar autoriteteve apo organeve drejtuese, sipas natyrës së problematikës të konstatuar, mbi parregullsitë e vërejtura së bashku me propozimet përkatëse. Në rast se pavarësisht këtyre rekomandimeve situata nuk ndryshon, KMSI vendos në dijeni, në mënyrë përfundimtare, sipas rastit Këshillin e Etikës, Senatin Akademik ose Rektorin për marrjen e masave përkatëse. Nëse nuk merren masa adekuate KMSI i drejtohen Asamblesë së Personelit Akademik.

Minimalisht në përfundim të çdo sezoni mësimor të vitit akademik, KMSI-të nxjerrin rekomandim mbi standardet e cilësisë në njësinë kryesore përkatëse.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

B. Në nivel njësie kryesore krijohen:

1. Komisionet e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme për çdo Fakultet, (KSBCF).

KSBCF përbëhen nga 7 anëtarë nga të cilët 6 janë personel akademik dhe 1 student, që vetëkandidohen dhe zgjidhen respektivisht nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore midis anëtarëve të saj dhe studentët me kohë të plotë të njësisë kryesore për përfaqësuesin e tyre, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për KSBCF. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërret zgjedhjet për anëtar të KSBCF, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit. Funksionet kryesore të këtyre komisioneve lidhen me garantimin e standardeve të cilësisë së institucionit si në aspektin akademik dhe në atë administrativ. KSBCF i kushtojnë një vëmendje të veçantë procesit mësimor për çdo program studimi, rezultateve akademike të studentëve dhe marrëdhënieve të tyre me personelin akademik.

Në ushtrim të këtyre funksioneve KSBCF harton rekomandime drejtuar KSBC në nivel institucional, autoriteteve apo organeve drejtuese, sipas natyrës së problematikës të konstatuar, mbi parregullsitë e vërejtura së bashku me propozimet përkatëse. Në rast se pavarësisht këtyre rekomandimeve situata nuk ndryshon, KSBCF vendos në dijeni sipas rastit Këshillin e Etikës, Senatin Akademik ose Rektoren për marrjen e masave përkatëse.

Minimalisht në përfundim të çdo sezoni mësimor të vitit akademik, KSBCF-të nxjerrin rekomandim mbi standardet e cilësisë në njësinë kryesore përkatëse.

2. Komisionet e marrëdhënieve me studentët për çdo Fakultet (KMSF).

KMSF përbëhen nga 7 anëtarë nga të cilët 6 janë personel akademik dhe 1 student, që vetëkandidohen dhe zgjidhen respektivisht nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore midis anëtarëve të saj dhe studentët me kohë të plotë të njësisë kryesore për përfaqësuesin e tyre, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për KMSF. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërret zgjedhjet për anëtar të KMSF, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit. Funkcionet kryesore të këtyre komisioneve lidhen me garantimin e standardeve të marrëdhënieve të fakultetit me studentët. KMSF i kushtojnë një vëmendje të veçantë marrëdhënieve të fakultetit me studentët, shërbimeve akademike dhe administrative ndaj tyre, rezultateve akademike dhe marrëdhënieve të tyre me personelin, strukturat, autoritetet/organet drejtuese të fakultetit.

Në ushtrim të këtyre funksioneve KMSF harton rekomandime drejtuar KMSI, autoriteteve apo organeve drejtuese, sipas natyrës së problematikës të konstatuar, mbi parregullsitë e vërejtura së bashku me propozimet përkatëse. Në rast se pavarësisht këtyre rekomandimeve situata nuk ndryshon, KMSF vendos në dijeni sipas rastit Këshillin e Etikës, Senatin Akademik ose Rektorin për marrjen e masave përkatëse.

Minimalisht në përfundim të çdo sezoni mësimor të vitit akademik, KMSF-të nxjerrin rekomandim mbi standardet e cilësisë në njësinë kryesore përkatëse.

C. Në Fakultetin e shkencave Teknike krijohet:

Komisioni i dhënies së gradës shkencore “Doktor”, (KDGD).

Ky komision përbëhet nga 7 anëtarë. Në këtë komision nuk mund të ketë anëtarë perfaqësues të studentëve.

1 Anëtarët e këtij komisioni mbajnë titullin “Profesor” ose “Profesor i asociuar”, vetëkandidohen dhe përzgjidhen nga Asambleja e personelit akademik të FSHT-së. Anëtarët e këtij komisioni kanë mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për këtë komision. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërret zgjedhjet për anëtar të komisionit, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit.

Fakulteti i Shkencave Teknike që zhvillon një program studimi të ciklit të tretë, e krijon menjëherë KDGD)-në, ndërsa fakultetet e tjera e krijojnë atë pasi të kenë marrë lejen përkatëse për të zhvilluar këtë tipologji/nivel programi dhe cikli studimi.



**REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK**

2. Vendimi regjistrohet dhe arkivohet.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.